

Gugash Magani: Mbijetesen dhe Kupen e Shqiperise

nga AlbaniaSoccer

E martë, 03 Dhjetor 2013 22:52



Trajneri i ri i Tiranës Gugash Magani pa frike ka deklaruar se skuadra e tij ka mundësi të mbijetojë dhe të fitojë gjithashtu Kupën e Shqipërisë. "Duke parë renditjen, për ne primar do të jetë kampionati sepse jemi në vend të fundit. Ndeshja e kupës është shumë e rëndësishme sepse Tirana e ka detyrim të luajë në të dyja kompeticionet dhe t'u shkojë gjërave deri në fund. Lushnja është një ekip shumë i fortë sidomos në fushën e vet, gjë që e tregoi edhe këtë fundjavë. Formacioni? Po ju them vetëm që nuk do të ketë shumë ndryshime, pasi nuk është momenti por ne do të luajmë me dy sulmues. Kushti që pranova të merrja drejtimin e bardhebluve ishte sepse mu dha garancia që në merkaton e janarit do të afrojmë lojtarë cilësorë në ekip, megjithatë unë besoj tek skuadra që kam", ka deklaruar Magani.